REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANI
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TE MJEDISIT

Datë:	05.04.2022
Referencë:	ZR
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës
Lënda:	**RAPORT MUJOR I PUNËS – MARS 2022**

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2022, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR TË PUNËS- PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.03.2022-31.03.2022

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT – mars 2022

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si:

• Përgatitja e propozim Vendimit dhe materialit për shpalljen nën mbrojtje të 9 Monumenteve të Natyrës. Këto Vendime janë miratuar në Kuvendin e Komunës.
• Përgatitja dhe prezantimi në Kuvendin e Komunës të propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Trafos në Lipjan sipas zgjidhjes teknike të parashtruar nga KEDS-i.
- Përgatitja e dokumentacionit kadastral për MKRS, përkatësisht për Institutin e Kosovës për Trashëgimi Kulturuore lidhur me projektin e UND për restaurimin e një numri të caktuar të shtëpive në Janjevë.
• Pjesëmarrja dhe aktivitetet e kryera në Komision për hartimin e Raportit për monitorimin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal.
• Pjesëmarrja dhe aktivitetet e kryera në kuadër të Komisionit për monitorimin e Kontratave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale.
• Pjesëmarrja dhe aktivitetet e kryera në kuadër të Komisionit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale;
• Pjesëmarrja në Puntorinë e organizuar nga VORAE në Lipjan përmes Programit KOSINT në temën "Procesi i legalizimit"

• Pjesëmarrja në Punëtorinë përmbyllëse të projektit Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës organizuar nga GIZ.
• Projektet komunale të parapara për implementim në vitin 2022 janë në proces të hartimit.

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar kërkesat e pranuara dhe kerkesat e bartura. Gjatë muajit mars 2022 janë pranuar gjithsejt 47 kërkesa, kurse lëndë të bartuara janë gjithsejtë 122 lëndë që rezulton në total 169 lëndë. Prej tyre janë trajtuar gjithsejt 57 kërkesa, janë miratuar 34, të refuzuara 18 kërkesa, të bartuara në sektorë tjerë 3 dhe te pezulluara 3 kërkesa.

Në procedurë të shqyrtimit janë gjithsejt 112 lëndë, të prezentuara në pjesën tabelare.

Tabela për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr i kërkesave të pranuara gjatë muajit mars	Nr. I kërkesave nga periudha e kaluar	Të Pezulluara	Miratuara	Refuzuara	Të bartura në sektor tjera	Në procedurë
1	Kushte ndërtimore	9	16	-	8	7	-	10
2	Leje ndërtimi/renovimi, vendosje e ob. te përkohshme	8	6	-	2	2	-	10
3	Leje rrënimi	-	-	-	-	-	-	-
4	Certifikatë perdorimi	1	3	-	-			3
5	LMK	-	-	-	-	-	-	-
6	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	4	74	-	2	1	-	75

	Në listë të pritjes							
7	Kërkesa të tjera	25	23	2	22	8	3	13
	Gjithsejt:	**47**	**122**	**2**	**34**	**18**	**3**	**112**

DISKUTIME PUBLIKE
Shqyrtimi publik për shpalljen nën mbrojte të monumenteve të natyres deri me datën 18 mars 2022.

SFIDAT
Personeli i kufizuar;
Numri i lartë i kërkesave të bartura.

REKOMANDIME
Me kërkesë të Agjencionit Kadastral të Kosovës dhe legjislacionit në fuqi duhet caktuar një zyrtar për bartjen e detyrave për trajtimin e sistemit të adresave.